



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORCE

VENDIM

Nr 70 date 11/9/2009

**PËR ULJEN E DISA TARIFAVE NË INSTITUCIONET
KULTURORE DHE SPORTIVE PËR NXËNËSIT DHE STUDENTËT
QË DO TË PAJISEN ME KARTËN 16-24**

Keshilli i Bashkise ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi morri ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Informacionit, mbeshtetur ne nenin 32 te ligjit Nr 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjin Nr 9632 date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar", ligjin Nr 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 24 date 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë":

VENDOSI

- 1.Uljen e tarifës së biletave për hyrjen në Teatrin "A.Z.Cajupi", Muzeu "Oriental Bratko", Stadiumin "Skenderbeu" dhe Pallatin e Sportit "Tamara Nikolla", me 50% të vlerës së tarifës për studentët dhe nxënësit e moshës nga 16-24, që studiojnë në Korçë apo që janë nga Korça dhe studiojnë në qytete të tjera dhe që pajisen me "Kartën 16-24".
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
Drejtoria e Informimit Qytetar dhe institucionet e sipërpërmendura.
- 3.Ky vendim hyn ne fuqi menjehere .

KRYETARI
Gjergji Pendayinji